

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## RREGULLAT E PROCEDURËS SË QIRADHËNJES SË ASETEVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Prishtinë, Gusht 2014

Në mbështetje të nenit 15 dhe 6.1.14 të ligjit për AKP-në nr.04/l-034, dhe në vështrimë të nenit 5.3 të Politikave Operacionale të Agjencisë, Bordi i Drejtoreve i Agjencisë Kosovare e Privatizimit, miraton:

## **Rregullat e Procedurës së qiradhënies së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore**

### **Hyrja:**

Këto Rregulla të procedurës përcaktojnë procedurat për qiradhënien e aseteve të patundshme dhe të tundshme ("Asetet") në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore ('NSH'), të drejtave dhe veprimtarive të NSH-së si dhe të aseteve në pronësi shoqërore pavarësishtë se a janë të organizuara në formë të personit juridik apo jo, të cilat bien nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) të përcaktuar sipas nenit 5 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ("Ligji i AKP-së")

### **Neni 1**

Rregullat e Procedurave të qiradhënjes duhet të janë në pajtim me nenin 15.2.2.9 të Ligjit të AKP-së, përvec të tjera shumë marrja lidhur me qiradhënien e Aseteve, të drejtave ose veprimtarive të NSH-ve, janë në kompetencë ekskluzive të Bordit të Drejtoreve të AKP-së.

### **Neni 2**

Këto rregulla të procedurës nuk zbatohen ndaj NSH-ve te të cilat ka filluar procedura e likuidimit sipas nenit 9 të Ligjit të AKP-së dhe shtojcës së këtij Ligji.

### **Neni 3**

Në procedurën e qiradhënies domosdoshmerisht aplikohet metoda e tenderit publik duke zbatuar njëkohësishtë parimet e konkurrencës së lirë, publike dhe transparencës. Në rast se objekt i qiradhëniës janë asetet apo të drejtat të cilat kanë të bejnë me një pjesë të konsiderueshme të veprimtarive më të rëndësishme të NSH-së përkatëse, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat ligjore të nenit 10.3 të Ligjit të AKP-së.

#### **Neni 4**

Propozimi për fillimin e procedurës për shpalljen publike të interesit për qiradhënien e asetit të caktuar i paraqitet Bordit të Drejtoreve të AKP-së nga ana e Menaxhmentit të AKP-së pas pranimit të rekomandimeve me shkrim nga ana e zyrës rajonale përkatëse.

Në propozim saktësisht duhet të precizohet dhe të përshkruhet aseti i cili propozohet për qiradhënie, afati i qiradhënie, kushtet specifike të kontratës së ardhshme të qiradhënie nëse janë të pranishme. Në rastet e qiradhënieve në vlera mbi € 1,000 mujore, para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet nga ofertuesi fitues të sjellë garacionin bankar (jo letër zotimi nga banka) në lartësinë e kontratës.

Komisioni për qiradhënien e Asetit në kuadër të kushteve specifike të përcaktuara në paragrafin dy (2) të këtij nenit, në shpallje publike të interesit për qiradhënie duhet të përcaktoj se qiramarrësi i ardhshem obligohet që të paguaj paraprakisht 1-3 (varësishtë prej diskrecionit të Komisionit) qira mujore me rastin e lidhjes së kontratës së qiradhënieve apo vazhdimit të saj.

#### **Neni 5**

Komisioni per qiradhënien e Asetit themelohet me vendim nga ana e Menaxhmentit të AKP-së pas pranimit të rekomandimeve për përbërjen e Komisionit nga ana e zyrës rajonale përkatëse të AKP-së.

Komisioni do të ketë në përbërje 3 anëtar dhe anëtar i këtij Komisioni domosdoshmerisht duhet të emërohet një zyrtar i AKP-se i cili propozohet nga ana e menaxherit të zyres rajonale përkatëse, një anetarë i komisionit do të jetë perfaqësuesi nga sindikata e punëtorëve dhe një anëtarë nga menaxhmenti i NSH përkatëse, kur objekt i qiradhënjës është aseti NSH-së i cili ka menaxhment aktiv.

Komisioni do të jetë 3 anëtar edhe në rastin tjetër kur objekt i qiradhënjës është (NSH) jo aktive por me një përbërje tjetër ku anëtarë të komisionit do të janë nga AKP-ja, me një përfshirje të domsodoshme të një zyrtarit të zyrës rajonale nga regjioni ku gjendet NSH-ja përkatësisht objekti qiradhënieve.

#### **Neni 6**

Në rast të qiradhënieve së aseteve të një NSH-je jo aktive e cila me rast AKP nuk ka mundësi që të identifikoj menaxhmentin e kësaj NSH -je, apo në rast të qiradhënieve se aseteve në pronësi shoqërore të cilat nuk janë të organizuara si persona juridik në Kosove, themelimin e Komisionit e bën me vendim menaxhmenti i AKP-së.

### **Neni 7**

Shpallja e interesit publik për qiradhënie bëhet në dy gazeta me tirazhë të madh në Kosove në gjuhen Shqipe dhe një gazetë në gjuhen Serbe që publikohet në Kosovë.

Shpenzimet të cilat ndodhin për realizimin e dhënies me qira të aseteve (shpalljet në gazeta, dërgime postare dhe kosto të tjera cilat ndërlidhen direkt) mbulohen nga fondet e NSH përkatëse dhe në rast të mungeses se këtyre fondevet, shpenzimet e shpalljes mbulohen nga tarifa administrative e AKP-së.

Kompenzimi apo kthimi i mjeteve ndaj tarifës administrative duhet të bëhet në momentin kur NSh-të përkatëse kanë realizuar të hyra, të hyra të cilat mbulojnë koston për realizimin e të dhënies me qira të aseteve.

### **Neni 8**

Organizimi i tenderit për qiradhënie bëhet në hapësirat e Zyrës Rajonale përkatëse.

Në mënyrë të përshtatshme zbatohen procedurat e Rregullave të Përgjithshme të Tenderit për Privatizim në veçanti paragrafet (c) (d) dhe (e) të nenit 4 të Rregullave të Përgjithshme të Tenderit.

### **Neni 9**

Hapja e ofertave bëhet vetëm nga ana e Komisionit në mënyrë publike në prani të ofertuesve.

### **Neni 10**

Ofertuesi fitues i përkohëshëm do të njoftohet brenda 7 ditë pune se mos bie në kategorinë e ofertuesve me ndalesë ofertimi.

### **Neni 11**

Kontrata e qiradhëniec lidhet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së rekandimit nga ana e Komisionit per menaxhimin e procedurave të qirardhënës. Kontrata për qiradhënje nënshkruhet në pajtim me aktin e themelimit të AKP-së.

Dispozita Kalimitare dhe të fundit

## Neni 12


Për të gjitha ndërmarrjet të cilat me vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë janë vendosur nën administrim direkt dhe në të cilat janë të emëruar Bordet e Përkohshme Menaxhuese procedurat e qiradhënjes do të udhëhiqen konform kësaj rregulloreje.

Komisioni për qiradhënie përbëhet nga tre (3) (anëtarë), dy (2) anëtar emërohen nga Bordi Drejtues i NSh-së, ndërsa një (1) anëtar i komisionit emërohet nga Agjencia (njësia për Adminsitritim Direkt).

Procedura për dhënjen me qira të pronës shoqërore të NSh-se e cila është në administrim direkt është e vlefshme vetëm atëherë kur merr aprovimin nga adiministrimi Direkt i AKP-së .

Procedurat e qiradhënjes së aseteve të Nsh-ve në Likuidim do të përgatitet nga AL në bashkëpunim me menaxhmentin e AKP-së.

Prishtinë, 26 Gusht 2014

Skender Komoni  
  
Zëvendës Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit